

Në mbështetje të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Ligji Nr. 05/L - 038, neni 14 dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2, të 11.05.2016, nenet 8,11,12 dhe 30, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e vet të mbajtur më 28 qershor 2018, nxori

RREGULLOREN **Për organizimin e koncerteve**

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e organizimit të koncerteve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: ASHAK).

Neni 2

ASHAK-u organizon koncerte me vepra muzikore të anëtarëve të Akademisë dhe të kompozitorëve të tjerë – në mjediset e ASHAK-ut dhe jashtë tij.

Neni 3

1. Organizimi i koncerteve bëhet në bazë të Programit vjetor të punës të ASHAK-ut.
2. Në raste të veçanta, me arsyetim përkatës të Seksionit të Arteve, koncertet që nuk janë përfshirë në Programin vjetor të punës, mund të organizohen me vendim të Kryesisë së ASHAK-ut.

Neni 4

1. Për organizimin e koncerteve, ASHAK-u i ka këto detyrime:
 - 1.1. Sigurimin dhe rregullimin e hapësirës për mbajtjen e koncertit;
 - 1.2. Përgatitjen e materialit promovues (të panosë, të ftesave dhe të programit të koncertit) sipas propozimit të Koordinatorit;
 - 1.3. Njoftimin për medie;
 - 1.3.1. Shpërndarjen e ftesave;
 - 1.3.2. Mbajtjen e rregullsisë para dhe gjatë koncertit; dhe
 - 1.3.3. Realizimin e pagesave për koordinatorin, për instrumentistët, për solistët dhe për personat e tjerë që do të angazhohen në koncert.

Neni 5

1. Seksioni i Arteve i ASHAK-ut është përgjegjës për organizimin e koncerteve dhe i ka këto detyra:
 - 1.1. Cakton koordinatorin për përgatitjen e koncertit – nga radhët e veta;
 - 1.2. Propozon në Kryesi vlerën e kompensimit për koordinatorin;
 - 1.3. Miraton propozimin e koordinatorit për instrumentistët, solistët dhe personat e tjerë që do të angazhohen në koncert;
 - 1.4. Propozon në Kryesi vlerën e kompensimeve për personat e cekur në nënparagrafin 1.3. të paragrafit 1 të këtij neni; dhe
 - 1.5. Cakton datën e mbajtjes së koncertit;
2. Caktimi i personave të cekur në paragrafin 1 të këtij neni bëhet në mbledhje të rregullt të Seksionit me vendim të veçantë.



- 2.1. Vendimi i dërgohet Shërbimit Profesional, Administrativ e Teknik të ASHAK-ut, i cili më pas ua përcjell personave të caktuar.

Neni 6

1. Koordinatori e udhëheq punën për organizimin e koncertit dhe i ka këto detyra:
 - 1.1. Bashkëpunon dhe e koordinon punën me Sekretarin e Seksionit dhe me Shërbimin Profesional, Administrativ e Teknik të ASHAK-ut.
 - 1.2. Paraqet me shkrim të gjitha kërkesat dhe nevojat për organizimin e koncertit;
 - 1.3. Miraton dizajnin e panosë, të ftesës dhe të programit të koncertit; dhe
 - 1.4. Ia propozon Seksionit të Arteve instrumentistët, solistët dhe personat e tjerë

Neni 7

Rregullorja hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë.

KRYETARI I AKADEMISË

Akademik Nexhat Daci

